



VENDIM

Nr. 96, Datë 17.06.2016

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT E ERE-S**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.06.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës, për Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, dhe relacionin përkatës,

Vendosi:

1. Të miratojë Rregulloren e Organizimit Funksionimit dhe procedurave të ERE. (bashkëlidhur).
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI